



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTRI

Nr. 9824 prot.

Tiranë, më 16.12.2020

URDHËR

Nr. 500 datë 16.12.2020

PËR

**ZGJIDHJEN E NJËANSHME TË KONTRATËS SË QIRASË NR.9525 PROT, NR.7686  
REP, NR.1882/2 KOL, DATË 12.12.2016 “PËR DHËNIEN ME QIRA TË TOKËS  
BUJQËSORE NË PRONËSI TË SHTETIT” ME PALË QIRAMARRËSE SHOQËRIA  
“LEVIDIAGRO ALBANIA” SHPK**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 Kodi Civil, i ndryshuar, Ligjin nr.8313, datë 01.04.1998 “Për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar, Vendimin nr.373, datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave procedurave dhe kontratës TIP për dhënie me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar dhe Kontratën e Qirasë Nr.9525 Prot, nr.7686 Rep, nr.1882/2 Kol, datë 12.12.2016 “Për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit”, neni 6 “Zgjidhja e kontratës”;

**KONSTATOVA SE :**

- Me Kontratën e Qirasë nr.9525 Prot, nr.7686 Rep, nr.1882/2 Kol, datë 12.12.2016 Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në cilësinë e qiradhënësit i ka dhënë me qira shoqërisë “Levidiagro Albania” shpk, tokën bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe prej 263.5148 ha, pasuritë me nr.51, nr.52, nr.64, nr.65, nr.75, nr.76, nr.87, nr.88, nr.100, nr.101, nr.102, nr.111, nr.112, nr.113, nr.114, nr.115, nr.116, nr.125, nr.126 Zona Kadastrale 3205, të cilat ndodhen në Njësinë Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës, Qarku Shkodër, me qëllim kultivimin, prodhimin, përpunimin dhe ambalazhimin e orizit, për një afat 90 (nëntëdhjetë) vjeçar.
- Nga verifikimi online në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar, rezulton se për subjektin “LEVIDIAGRO Albania” shpk, NUIS L61806020S, më datë 11.5.2020 është vendosur prishja e shoqërisë dhe ka kaluar në statusin “Shoqëri në likuidim e sipër”, për rrjedhojë kjo shoqëri është çrregjistruar nuk ekziston më si person

juridik, ka humbur personalitetin juridik dhe nuk mund të ushtrojë asnjë lloj veprimtarie ekonomike e tregtare në funksion të kontratës së qirasë të lidhur me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Neni 690, parashikon se “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjelltë të palëve ose për shkaqe të parashikuara në ligj”;

Sa më sipër :

### URDHËROJ

1. Zgjidhjen e njëanshme të Kontratës së Qirasë nr.9525 Prot, nr.7686 Rep, nr.1882/2 Kol, datë 12.12.2016, me palë kontraktore: Qiradhënës Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Qiramarrës shoqëria “Levidiagro Albania” shpk, me objekt “Dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqen prej 263.5148 ha, pasuritë me nr.51, nr.52, nr.64, nr.65, nr.75, nr.76, nr.87, nr.88, nr.100, nr.101, nr.102, nr.111, nr.112, nr.113, nr.114, nr.115, nr.116, nr.125, nr.126, Zona Kadastrale 3205, të cilat ndodhen në Njësinë Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës, Qarku Shkodër”.
2. Të procedohet me çrregjistrimin e kontratës së qirasë në regjistrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë,

